

## Permbledhje Joteknike

*ID 10.4 Riparimi dhe mirembajtja e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motocikletave nqs nuk jane permendur dikur tjeter ne kete shtojce.*

*ID 7.12, germa g. Lyerja dhe lustrimi i makinave.*



**Person Fizik:** Bledi HAKA



**Nipt:** K71603008B

**Adresa qendrore:** Tirane Petrele PETRELE Fshati Stermas, lagjja Çeliku, rruga nacionale Tirane-Elbasan nr 5, godine 1-kateshe, zona kadastrale 3517, nr.pasurie 84/30, nr.pasurie 85/8.

**Tabela përmbledhese e permbjedhjes joteknike**

<b>1. Profili I operatorit</b>	<b>3</b>
<b>1.1 Proçesi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis</b>	<b>3</b>
<b>1.2 Kerkesat per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis te nje projekti</b>	<b>3</b>
<b>2. Përshkrimi i Instalimit;</b>	<b>5</b>
<b>2.1 Qellimi;</b>	<b>5</b>
<b>2.2 Subjekti investitor;</b>	<b>5</b>
<b>2.3 Vendodhja e ushtrimit te aktivitetit;</b>	<b>5</b>
<b>2.4 Te dhena teknike te aktivitetit;</b>	<b>5</b>
<b>3. Identifikimi dhe vleresimi I shkarkimeve kryesore ne mjedis;</b>	<b>8</b>
<b>4. Identifikimi dhe vleresimi I ndikimeve ne mjedis te aktivitetit;</b>	<b>9</b>
<b>4.1 Analizimi I ndikimeve te pritshme ne mjedis;</b>	<b>10</b>

## 1. Profili I operatorit

Personi Fizik **Bledi HAKA** do te pajiset me Leje Mjedisi tipi B, sipas legjislacionit aktual ne fuqi, per aktivitetin:

**ID 10.4 Riparimi dhe mirembajtja e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motocikletave nqs nuk jane permendur dikur tjeter ne kete shtojce.**

**ID 7.12, germa g. Lyerja dhe lustrimi i makinave.**

**Personi fizik eshte** i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me Nipt **K71603008B** dhe vendndodhje te ushtrimit te aktivitetit Tirane Petrele PETRELE Fshati Stermas, lagjja Çeliku, rruga nacionale Tirane-Elbasan nr 5, godine 1-kateshe, zona kadastrale 3517, nr.pasurie 84/30, nr.pasurie 85/8.

Qellimi i ketij projekti eshte riparimi i automjeteve dhe motocikletave dhe lyerja dhe lustrimi i makinave. Zhvillimi i ketij aktiviteti eshte funksionimi sipas standarteve dhe dhenia e nje sherbimi te pelqyer nga klientet.

Nenshkrimi i nje sere konventash dhe miratimi i kuadrit ligjor per mjedisin ne funksion te tyre, detyron institucionet shtetore dhe subjektet fizike e juridike ti nenshtrohen disa procedurave vleresimi te impaktit te tyre para ndertimit dhe venies ne funksion te aktivitetit.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) eshte nje prej instrumentave parandalues dhe minimizues te ndikimit mjedisor dhe per projektin specifik, hartohet duke u bazuar ne kerkesat e zhvillimit te aktivitetit nga personi fizik **Bledi HAKA**.

Ky raport perfshin vleresimin, identifikimin, si dhe percaktimin e masave zbutese te ndikimit ne mjedis te aktivitetit.

### 1.1 Procesi i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e zhvillimit te aktivitetit. Në procesin studimor të VNM përdoret informacioni dhe të dhënat teknike ekzistuese. Vleresimi i ndikimit ne mjedis hartohet qe ne fazen e projektidese per zhvillimin e aktivitetit, por gjithsesi edhe per aktivite ekzistuese te cilat jane objekt i nje leje mjedisore ose i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Sipas kushtetutes se Republikes se Shqiperise, shteti siguron me te gjitha mjetet dhe mundesite qe ka, nje mjedis te paster dhe te sigurte per qytetaret dhe brezat e ardhshem.

### 1.2 Kërkesat Vlerësimin te Ndikimit në mjedis të një projekti

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj.

Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

## 2. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

### 2.1 Qellimi i aktivitetit

Qellimi i funksionimit të ketij aktiviteti është riparimi i automjeteve dhe motocikletave, stukimi dhe lyerja e tyre dhe funksionimi i tyre, duke marrë parasysh të gjithë dispozitat ligjore në fuqi, gjithashtu duke minimizuar në mënyrën më të mirë ndikimet në mjedis që mund të lindin nga zhvillimi i ketij aktiviteti.

Në këtë raport vlerësimi do të vlerësojë vetëm ndikimet e ndertimit dhe funksionimit.

### 2.2 Subjekti investitor

Personi Fizik Bledi HAKA do të ushtrojë aktivitetin në fushën e mirëmbajtjes së automjeteve dhe lyerjes së tyre.

### 2.3 Vendodhja e aktivitetit

Adresa në të cilën do të zhvillohet aktiviteti është Tirane Petrele PETRELE Fshati Stermas, lagjja Çeliku, rruga nacionale Tirane-Elbasan nr 5, godine 1-kateshe, zona kadastrale 3517, nr.pasurie 84/30, nr.pasurie 85/8.

### 2.4 Te dhena teknike të aktivitetit

*ID 10.4 Riparimi dhe mirëmbajtja e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motocikletave nëq nuk janë përmendur dikur tjetër në këtë shtojcë.*

*ID 7.12, germa g. Lyerja dhe lustrimi i makinave.*

Aktiviteti që ushtron subjekti “**Vol-Al Service**” sh.p.k është shërbimi për automjete autoservis. Në këtë pikë servisi, proceset e punës kryhen sipas një radhe të caktuar. Makina, motorri apo mjete tjetër motorrik që do të kontrollohet, i nënshtrohet disa kontrolleve nga ana e xhenerikeve të punësuar në këtë subjekt, duke filluar që nga:

#### **Kontrolli Visual (kontrolli fizik) me sy**

Sisteme dhe pjesë që kontrollohen vizualisht në automjetet e ardhura në këtë servis janë:

- Sistemi i ndriçimit dhe sinjalistikës së jashtme,
- Gjendja e të gjitha gomave dhe rrotave,
- Kroskoti i automjetit dhe funksionimi i tij,
- Fshirëset dhe larëset e xhamave,
- Sistemi elektrik,
- Të gjithë elementet që lidhen me sistemin e frenimit (pedalet, levat, tubat etj.)
- Të gjithë elementet që lidhen me sistemin e drejtimit (nyjet, gominat etj.)
- Funksionaliteti dhe siguria e dymëve, dritareve dhe pasqyrave,
- Ndenjëset dhe funksionimi i rripave të sigurimit,
- Gjendja e shasisë së automjetit,
- Konsumim jo i rregullt i pneumatikëve,
- Kauçuku i pastrueses së xhamit të dëmtuar.
- Xhamat e fenereve dhe të dritave të dëmtuara.
- Pasqyrat e lira.
- Antena e këputur.

- Rrjedhje në motor.
- Rrjedhje në sistemin e shkarkimit
- Pllakat e frenave të konsumuara
- Niveli i rezeruarit.
- Aksesorët që mungojnë ose janë të dëmtuar.
- Rrota rezervë që mungon.
- Dëmtime të karrocërisë që klienti nuk dëshiron ti riparojë.

Pasi është bërë kontrolli visual, mjeti motorrik, automobili, makina apo motorri kalon në **Kontrollin teknik me pajisje diagnostifikuese**, një metode kjo e përdorur për të identifikuar defektet që ka rritur shkallën e besueshmërisë tek klientët dhe ka përmirësuar cilësinë e fazës së kontrollit të automjetit. Programet kompjuterike të kontrollit përditësohen sa herë kompania e prodhimit të automjetit nxjerr një model të ri të markës përkatëse.

Ky lloj kontrolli konsiston kryesisht në:

- Diagnostikim i defektit me aparaturë kompjuterike.
- Diagnostikim në banko-provë për sistemet e frenimit, drejtimit dhe amortizimit.

Disa nga proceset e mirëmbajtjes që kjo pike servisi ofron janë:

- Zëvendësimi i vajit të motorrit dhe filtrit të vajit, të filtrave të karburantit, filtrit të ajrit dhe filtrit të kabinës në bazë të kilometrave të përshkruara nga automjeti dhe përcaktimi i ndërrimit të rradhës.
  - Testimi dhe zëvendësimi i vajit të frenave, plotësimi i nivelit të depozitës së vajit të frenimit.
  - Kontrolli i sistemit të frenimit, zëvendësimi i ferrodave dhe disqeve të konsumuara, regjistrimi i frenave të këmbës dhe të dorës.
  - Kontrolli i sistemit të ndezjes dhe plotësimi i nivelit të elektrolitit në akumulatorin e motorrit, zëvendësimi i kandeleve në automjetet me benzine dhe gaz në bazë të kilometrave të përshkruara.
  - Kontrolli i presionit të ajrit të gomave dhe rregullimi i këtij presioni në nivelin e rekomanduar nga xheneriku.
  - Përgatitja e antifrizës në parametrat e duhur në sistemin ftohes të motorrit.
  - Kontrolli i sistemit të kondicionimit të ajrit dhe zëvendësimi i gazit ftohes pas testimit të tij.
  - Vendosja e sinjalizuesve dhe ndricuesve të dëmtuar dhe kontroll i detajuar i sistemit të sinjalizimit-ndricimit.
  - Kontrolli i kutisë së shpejtësisë dhe i diferencialit për nivelin e vajit dhe plotësimi i tij në raste nevojë.
- **Me Sherbim Teknik** të mjeteve motorrike do të konceptohet teresia e operacioneve teknike që kryhen në to, të parashikuara që me parë ku hyjnë : pastrimi ,larja , shtrengimet e ndryshme ,punimet e regjistrimeve të detaleve dhe të mekanizmave të

ndryshem , kontrolli i nyjave dhe i mekanizmave , grasatimi, kontrolli i nivelit dhe nderrimi i vajit ne motor, kontrolli i nivelit të vajit ne kutinë e shpejtësisë diferenciale etj. Nepermjet ketyre operacioneve zbulohet ne kohe dhe parandalohet lindja e çrregullimeve te ndryshme nga njera ane dhe nga ana tjeter zvogelohet konsumimi i detaleve duke menjanuar shkaqet qe e pershpejtojne kete konsumim.

#### **Sherbimi Teknik bazohet ne:**

- **Në mirëmbajtjen e përditshme (MP)** ku duhet të kryhen këto veprime:
  1. Kontrolli i gjendjes teknike të automjetit. Ky kontroll ka për qëllim që të sigurojë lëvizjen pa rrezik të automjetit në rrugë.
  2. Furnizimi i automjetit me materialet shfrytëzuese (lëndën e djegëshme, lëndët lyrësuese (vajosëse), lëndët ftohëse, lëndët frenuese etj), që të sigurohet puna normale e tij.
  3. Sigurimi i një pamjeje të jashtme të rregullt të automjetit. Për këtë qëllim mirëmbajtja e përditshme e automjeteve kryhet çdo ditë.

#### **Në punimet e mirëmbajtjes së përditshme hyjnë:**

1. Punimet e kontrollit të gjendjes dhe të veprimit të mekanizmit të drejtimit (sistemit të drejtimit dhe sistemit të frenimit), nga puna e të cilëve varet siguria e lëvizjes.
2. Aparatet e ndriçim-sinjalizimit, të karrocërisë dhe kabinës.
3. Kontrolli dhe korrigjimi i nivelit të vajit në motor dhe në agregatet e tjera (shtohet vaj për këta mekanizma duke arritur në nivelin e duhur).
4. Kontrolli i nivelit të ujit në sistemin e ftohjes.

Mirëmbajtja e përditshme kryhet çdo ditë nga vetë drejtuesi i mjetit. Shoferi në çdo çast vrojton me kujdes mjetin që drejton, degjon gjithmonë punën e agregateve kryesore të automjeteve.

- **Gjatë shërbimit teknik 1 (SHT-1)** kryhen këto veprime:

1. Kontrolli i jashtëm teknik i të gjithë automjetit.
2. Kryerja e një vëllimi të caktuar të punimeve të kontrollit, të shtrëngimit, regjistrimit, vajosjes, punimeve elektrike dhe furnizimit.
3. Kontrolli i punës së motorit, i mekanizmit të kthimit, të frenimit dhe i mekanizmave të tjerë në lëvizje.

Punimet e shërbimit teknik 1 kryhen pa bërë çmontimin e nyjeve dhe agregateve të ndryshme të automjetit.

#### **Gjatë shërbimit teknik 2 (SHT-2)** kryhen:



1. Kontrolli më i thelluar i gjendjes teknike të të gjithë mekanizmave dhe aparateve të automjetit. Për këtë qëllim aparatet e ushqimit dhe aparatet e sistemit elektrik hiqen nga automjeti dhe kalojnë për kontroll në repartet e kontroll-regjistrimit të tyre.
2. Kontrolli i agregateve, mekanizmave dhe aparateve të automjetit në lëvizje e sipër.

**Me Riparim te Automjeteve** do te kuptojme evitimin e defektit te konstatuar duke ndërruar te gjitha pjeset e konsumuara e te demtuara dhe rikthimin ne pune te automjetit me parametra normale te gjithe agregateve perberes te tij.

Paisjet dhe veglat e punes që perdoren në kete servis janë të shumta duke filluar nga ato më të thjeshtat deri tek ato speciale për automjete të caktuara, kjo dhe në varësi të madhësië së servisit dhe te llojit të shërbimeve që ky do të ofrojë. Ne pajisjet kryesore vlen te permendim:

### **Vinçi (Lifti)**

Roli i vinçave në servis është jetik për çdo specialist, për kontrollin e te gjitha pjeseve xhenerike, per zevendesimin e tyre, per montimin dhe cmontimin e te gjitha pjeseve qe jane te lidhura me shasine e motorrit. Ka shumë lloje të vinçave qe perdoren ne servise duke u klasifikuar ne baze te peshengritjes dhe menyres se kapjes se tij me shasine se tyre.

### **Kompresor ajri**

Shërben për prodhimin e ajrit të ngjeshur që përdoret ne disa paisje të servisit. Kompresori zgjidhet me kapacitet te ndryshem, p.sh 200L, 300L, 500L etj. ne bazë të nevojave për ajër ne servis të llogaritura me pare, ne varesi te punes dhe te numurit të paisjeve pneumatike që do të përdoren në servis.

### **Grumbullusi i vajit**

Shërben per zëvendesimin e vajit ne automobil. Eshte grumbullues me vetërrjedhje vaji dhe pneumatik. Në rastin e grumbullusit pneumatik ai është i paisur me disa tuba thithës te cilat përshtaten me tubat e kontrollit të nivelit të vajit dhe nëpërmjet vakumit që krijon paisja bëhet e mundur nxjerja e vajit nga motori.

### **Presë Hidraulike**

Kjo presë shërben për çmontimin dhe montimin e kuzhinetaes, bokollave të ndryshme dhe gominave që gjendennyjet the agregatat e motorrit. Perdorimim i kësaj pajisje ben të mundur montimin sipas kushteve teknike te detaleve me shtrengim.

### **Pajisje diagnostifikuese**

Nëpërmjet pajisjes diagnostifikuese diagnostikohen difektet e shfaqura ne automjet tek te cilat nje pjesë e sistemeve te ndertimit te tyre komandohen nga paketa elektronike nëpërmjet skemave te ndryshe elektronike. Kjo realizohet nepërmjetë kompjuterave speciale dhe programeve perkatese per secilin tip qe e lejon nje diagnostifikim te tille, programe qe prodhohen per cdo seri prodhimi te tipeve te ndryshme automjetesh.

Keto paisje mund te jene stacionare ose portabile. Me pajisjen më inovative të teknologjise diganostike ofrohet përcaktimi universal i diagnozëns. Kjo paisje është e njëjtë per shumë



markat dhe iu përshtatet këtyre markave të njohura nëpërmjet softereve përkatës, duke kursyer në këtë mënyrë aparatet e shumta që mund të përdornim për secilën markë.

### **Kutia e ndihmes së shpejte**

Një nder pajisjet e rëndësishme të përdorura në këto servise është edhe kutia e ndihmes së shpejte, e cila është e vendosur në një vend të caktuar në ambientet e këtij subjekti. Funkcioni i saj është të ndihmojë punonjësit në rastet e lëndimit, plagosjeve apo aksidentesh të papritura gjatë proceseve të punës.

Subjekti gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij dhe për kryerjen e proceseve të punës përdor lende të para siç janë pjesët për makina e motorra të tilla si ferrotat, disqet, kushinetat, pompat e filtrat e ajrit, vajit e naftës. Nder lëndet ndihmese të përdorura gjatë kryerjes së proceseve të punës përmenden lubrifikantet e llojit të markave të ndryshme, si: vajra motorri e hidraulike.

Për sa i përket aktivitetit të lyerjes subjekti do të përdorë teknologji të përparuar e cila bën të mundur emetimin e ulet të aromave apo cdo substance tjetër të rrezikshme. Lyerja kryhet në një dhomë të vecantë të izoluar me qëllim ruajtjen e mjedisit. Ky proces do të kryhet me pompe, sipërfaqe të nxjerrjes së bojës shkon direkt në sipërfaqen e pjesës që do të lyhet. Ky proces shoqërohet pa shkarkime.

### **3. Identifikimi dhe Vlerësimi i Shkarkimeve në mjedis**

Mjedi është gjithmone i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jetë i ndryshëm, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtëpërdrejtë, të terthorë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm. Nga zhvillimi i aktivitetit pritet që të ketë shkarkime minimale në mjedis, duke iu referuar edhe natyrës së tij. Disa nga shkarkimet e mundshme të këtij aktiviteti janë si më poshtë vijon:

1. **Shkarkime në ajër**- Në këtë grup shkarkimesh do të listojmë shkarkimet e gazrave nga motorret me djegie të brendshme, që mund të gjenerohen si pasoje e mberitjes së mjeteve në servis. Këto shkarkime do të jenë lehtësisht të menaxhueshme dhe të monitorueshme. Krahasuar me aktivitetet e po të njëjtit lloj, mund të themi se janë shkarkime normale. Për sa i përket shkarkimeve nga sektori i lyerjes nuk do të kemi, sepse teknologjia është e standartizuar dhe bashkohore. Bojrat do të përdoren ekologjike dhe të certifikuar CE.
2. **Shkarkime në ujë**- Kjo tipologji shkarkimi do të jetë prezente vetëm si pjesë e shërbimeve higjieno-sanitare. Për sa i përket shkarkimeve nga zhvillimi i aktivitetit, nuk do të kemi pasi këto lloj aktivitetesh nuk shoqërohen me shkarkime.
3. **Shkarkimet në tokë**- Aktiviteti që personi fizik Bledi Haka, do të zhvillojë nuk shoqërohet me shkarkime në tokë. Mbetje e vajrave dhe cdo lloj mbetje tjetër që mund të cenon mjedisin do të evadohet sipas legjislationit në fuqi.

### **4. Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve në mjedis të aktivitetit**

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm

Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake

Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore

Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit

Parimi i qasjes së integruar

Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit

Parimi “Ndotësi paguan”

Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut

Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe VKM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;

#### **4.1 Ndikimet e pritshme ne mjedis nga zhvillimi I aktivitetit**

Ndikimet e mundshme gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permbliidhen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

Ndikime ne toke	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Riparimi i automjeteve	Mund të kemi rrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari me pasojë ndotje të tokës.

Ndikime ne uje	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi	Rrjedhje vajrash dhe lubrifikantësh nga automjetet e parkuar ne menyre aksidentale.  <i>Per kete aresye operatori do te marre masa te menjehershme dhe do te bej te mundur lokalizimin e zones ne rast avarie dhe pastrimin e saj ne menyre te menjheershme me qellim qe keto derdhje aksidentale mos takohen me ujin.</i>

Ndikime ne biodiversitet	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi	Zhvillimi i aktivitetit nuk do te shoqerohet me ndryshime ne peisazh apo ne biodiversitet.

Ndikime ne ajer	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi	Si pasojë e mberritjes ne ambjentet e servisit do te kemi prezence te: <ul style="list-style-type: none"><li>- zhurma,</li><li>- pluhur,</li><li>- gaze nga djegia e karburantit të motorëve.</li></ul>